

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"ANKASAV CONSTRUCTION"**

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, me date 07.04.2023, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emrin "ANKASAV CONSTRUCTION" SH.PK

(2) Themeluesi i shoqërisë është ortaku i vetëm:

Zoti SINAN YUMUS, lindur ne Ankara, Turqi, me 03.05.1983, shtetas Turk, mbajtës i pasaportës me nr. U27512883, madhor dhe aftësi te plota juridike

**Neni 2:**  
**Objekti**

2.1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Punime per instalime dhe ndertime me konstruksione metalike

2.2 Shoqëria do te kryeje çdo lloje veprimtarie te dobishme për arritjen e objektivave te saj, duke përfshire edhe veprimtari për shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesëmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqëri dhe ndërmarrje te tjera.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4:**  
**Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Durres RRASHBULL Njesia Administrative Rrashbull, Banesa me nr.pasurie 94/175, Zona Kadastrale nr 3215, kat i II-te, ap 4.

Shoqëria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci ne adresa te tjera ne territorin e Republikës se Shqipërisë se jashtë vendi.

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 Lekë (njëqind mijë).

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është:

1. Ortaku themelues, Zoti SINAN YUMUS, lindur ne Ankara, Turqi, me 03.05.1983, shtetas Turk, mbajtës i pasaportës me nr. U27512883 : Zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 Lekë (njëqind mijë), që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit behet nga ortaku i vetem, i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek ortake te tjere, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Ortaku i vetem eshte autoriteti i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i vetem eshte autoriteti i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

2

Ortaku i vetem eshte autoriteti i vetem përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku i vetem mund të përfaqësohet, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

#### Neni 9 Administrimi

(1) Ortaku i vetem emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


(2) Administratoi/rët i shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administratorë i shoqërisë:

Të dhënat e identifikimit:

- **Zoti SINAN YUMUS**, lindur ne Ankara, Turqi, me 03.05.1983, shtetas Turk, mbajtës i pasaportës me nr. U27512883, madhor dhe aftësi te plota juridike per te vepruar.

- Speciment i nënshkrimit:

  
**Neni 10**

**Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:



- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte i detyruar te informoje ortakun, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Ortaku i shoqerise mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 11 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) i kthen ortakut te vetëm kontributet;

b) i paguan ortakut te shoqërisë interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku i vetëm, ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV  
Viti finanziar-ekspertet

## Neni 12

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

## Neni 13

### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe tё kontrolloje tё gjithe dokumentacionin kontabel tё veprimtarise ekonomiko tregtare tё shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike tё ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje tё tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim tё kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit tё bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike tё ushtruara, tё cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e tё drejtës vendimore qe ka.

## Kreu V

### Prishja -riorganizimi i shoqërisë

## Neni 14

### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tё behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim tё Ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave tё falimentimit;
- ç) nёse nuk ka kryer veprimtari tregtare pёr dy vjet dhe nuk ёshtë njoftuar pezullimi i veprimtarisë nё pёrputhje me pikën 3 tё nenit 43 tё ligjit nr.9723, datё 3.5.2007 "Pёr Qendrën Kombëtare tё Regjistrimit";
- d) me vendim tё gjykates;

Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne tё cilin parashikojne menyren e likuidimit tё shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tё nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tё likuidimit nё gjendjen e aftësisë paguese, me pёrjashtim tё rasteve kur ёshtë nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Nёse Ortaku nuk merr një vendim pёr emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditёve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, pёr tё caktuar një likuidues.

## Neni 15

### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Ortakut, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 16

#### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

#### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**O R T A K U I VETEM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ANKASAV CONSTRUCTION"**

SINAN YUMUS

*Sinan Yumus*

